

| Nr. Rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|------------|-----------------|-------------------------|-------------------|--|----------------------------------|--------|
| 1 | 29.12.2025 | Kërkesë për informacion | 16.01.2026 | <p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) ju informon se rezervimi online i shërbimit të kontrollit teknik të mjetit mund të verifikohet pranë sportelit përkatës të shërbimit. Vetëm në rastet kur konstatohet mungesë komunikimi me portalin e-Albania ose problematika teknike në funksionimin e sistemit informatik, kërkohet paraqitja e emailit konfirmues të ardhur në adresën elektronike të qytetarit, si provë e realizimit të rezervimit.</p> <p>Lidhur me ambientin e Qendrës së Kontrollit Teknik(QKT) Shkodër, sqarojmë se, në rastet kur mjete të tjera pa rezervim janë të parkuara në hyrje, anashkalimi i tyre është i pamundur për shkak të konfigurimit dhe planimetrisë së rrugës hyrëse, e cila shërben si kalim i vetëm. Në këto kushte, trupa inspektuese, në çdo rast, ofron asistencën e nevojshme për vijimin e shërbimit, si dhe sqarimet përkatëse për qytetarët e tjerë që nuk disponojnë rezervim online.</p> <p>Duke qenë se nuk është e mundur të parashikohet me saktësi paraqitja ose jo e mjeteve me rezervim në orarin e caktuar, mbajtja e radhës së dedikuar për rezervimet online rezulton e pamundur për t'u garantuar në çdo rast. Për këtë arsye, DPSHTRR po vlerëson rishikimin e mënyrës së aplikimit të rezervimit online në QKT Shkodër, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të fluksit dhe cilësisë së shërbimit.</p> | E plotë | 0 |
| 2 | 21.01.2026 | Kërkesë për informacion | 27.01.2026 | <p>Në vijim të e-mail dërguar nga ana Juaj më datë 21.01.2026 "Kërkesë për informacion zyrtar mbi ndalimin dhe procedurën e rregullimit të qarkullimit të monopatinave elektrike (scooterave elektrike)", protokolluar në DPSHTRR me Nr. 1276 Prot., datë 21.01.2026, ju informojmë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - DPSHTRR-ja është institucion që kryen procedura shërbimi për mjetet dhe drejtuesit e mjeteve, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Nuk është as detyrë dhe as kompetencë e DPSHTRR-së, ndalimi i qarkullimit në rrugë të monopatinave elektrike; - Në lidhje me procedurën administrative dhe/ose ligjore për rregullimin e mundësisë së qarkullimit të monopatinave elektrike ato janë në kompetencë të ministrive përgjegjëse (Ministrisë së Brendshme, Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë etj.). Institucioni jonë, nëpërmjet specialistëve të fushës, kontribon në këtë zhvillim me kërkesë të tyre; - E vlerësojmë shqetësimin Tuaj dhe Ju sigurojmë se me daljen e akteve ligjore që kanë të bëjnë me regjistrimin e monopatinave, DPSHTRR-ja do të marrë masat e menjëhershme për zbatim të tyre. <p>Faleminderit për mirëkuptimin,</p> | E plotë | 0 |
| 3 | 24.01.2027 | Kërkesë për informacion | 26.01.2026 | <p>Në vijim të mesazhit tuaj, ju bëjmë me dije se kërkesa e përcjellë nuk është e qartë dhe informacioni i dhënë nuk është i mjaftueshëm për shqyrtim. Gjithashtu, videoja e bashkëlidhur nuk është e aksesueshme.</p> <p>Ju lutemi të na dërgoni kërkesën e plotë dhe ta ribashkëlidhni materialin në format të aksesueshem, në mënyrë që DPSHTRR ta shqyrtojë rastin tuaj.</p> <p>Faleminderit për mirëkuptimin.</p> | E plotë | 0 |
| 4 | 10.03.2026 | Kërkesë për informacion | 10.03.2026 | <p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, paraqitur në bazë të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", ju bëjmë me dije se:</p> <p>Për ushtrimin e aktivitetit të transportit ndërkombëtar të mallrave me mjete rrugore nga shoqëri të themeluara në Republikën e Shqipërisë, kërkohet pajisja me licenca dhe dokumentacion përkatës, në varësi të llojit të aktivitetit që kërkohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> Licencë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira; Certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vet. <p>Lidhur me kërkesën tuaj për një kopje të përditësuar të Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", ju informojmë se një kopje e këtij akti ju vihet në dispozicion bashkëlidhur këtij emaili.</p> <p>Faleminderit.</p> | E plotë | 0 |
| 5 | 16.03.2026 | Kërkesë për informacion | 24.03.2026 | <p>Në bazë të periudhës kohore që kërkoni për të dhënat dhe indikatorët, do të lidhet një marrëveshje ndërmjet institucioneve dhe do të informoheni për pagesën e shërbimit që do të merrni.</p> | E plotë | 0 |